



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 202200952/2

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2022

**Lënda :** *Rekomandim për inspektimin e kryer në Qendrën Provizore të Pritjes së migrantëve të parregullt në Kapshticë, në Drejtorinë Rajonale për Kufirin dhe Migracionin (DRKM), Korçë.*

**Drejtuar :** **Drejtues i Lartë Saimir BOSHNJAKU**  
**Drejtor i Departamentit për Kufirin dhe Migracionin**  
**Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit**

**TIRANË**

**Drejtues Fatmir HOXHA**  
**Drejtor i DRKM-së në Korçë**

**KORÇË**

**Për dijeni: Drejtues Madhor Muhamet RRUMBULLAKU**  
**Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit**

**TIRANË**

*Të nderuar zotërinj,*

Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar (MKPT), seksion pranë institucionit të Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, zhvilloi një inspektim në Qendrën Tranzitore të pritjes dhe akomodimit të emigrantëve të parregullt në Kapshticë, në varësi të Drejtorisë Rajonale për Kufirin dhe Migracionin, Korçë.

Inspektimi u krye në datë 04.07.2022, sipas Planit të Inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit. Grupi i inspektimit përbëhej nga z.Besnik Deda dhe z.Hazbi Selita, me detyrë nd/komisioner pranë Mekanizmit Kombëtar, si dhe eksperti për çështjet e migracionit i institucionit të Avokatit të Popullit pranë DRKM Korçë, z.Rexhep Lala.

Qëllimi i inspektimit ishte vlerësimi i përgjithshëm i kushteve infrastrukturore në Qendrën Provizore të pritjes së migrantëve të parregullt në Kapshticë, si dhe respektimi i të drejtave

dhe trajtimi i migrantëve të huaj, sipas dispozitave ligjore të parashikuara në legjislacionin tonë, si dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar, për këtë qëllim.

Vija kufitare në zonën e Kapshticës, konsiderohet nga grupet e migrantëve të parregullt, si porta më e mundshme për të depërtuar nga territori i Greqisë për në territorin e vendit tonë. Nga informacioni i punonjësve të policisë të SPK Kapshticë rezulton se, grupet migratore që mbërrijnë në Shqipëri nuk e konsiderojnë vendin tonë si destinacion për qëndrim të përhershëm, ndaj dhe një numër shumë i vogël i tyre kërkojnë azil. Pjesa tjetër, përmes pikave kufitare tokësore në veri të vendit, vazhdojnë rrugëtimin drejt Kosovës apo Malit të Zi, me synimin për të depërtuar në vendet e BE-së.

Migrantët pasi identifikohen në kufi, në afërsi të tij apo brenda në territorin e vendit tonë, shoqërohen nga patrullat e policisë kufitare në bashkëpunim me punonjësit e FRONTEX-it, për në Qendrën Tranzitore të pritjes së migrantëve të parregullt, e cila ndodhet në afërsi të stacionit të policisë kufitare në Kapshticë.

Për periudhën Janar-Qershor 2022, në këtë Qendër janë shoqëruar dhe akomoduar **2328 persona**, nga të cilët 1360 persona kanë hyrë për herë të parë në territorin e Shqipërisë dhe 968 persona janë përsëritës. Grupet e migrantëve që konsiderohen me risk janë gratë dhe fëmijët nën moshën 18 vjeç. Statistikat tregojnë se, gjatë kësaj periudhe kanë hyrë në mënyrë të parregullt **81** fëmijë nën moshën 18 vjeç, **32** gra mbi moshën 18 vjeç dhe 17 vajza nën moshën 18 vjeç. Referuar shtetësisë, migrantët në shumicën e tyre kanë qenë nga Siria, Iraku, Palestina, Maroku, Afganistani, Algjeria etj.

Krahasuar me vitet e fundit, për periudhën e parë 6-mujore të vitit 2022, ka patur një rënie të fluksit të migrantëve që kanë hyrë në territorin e Shqipërisë nga kjo pikë kufitare. Për këta persona janë kryer procedurat për identifikimin, intervistimin dhe përzgjedhjen e tyre, sipas procedurave ligjore. Konkretisht, për vitin 2020 kanë hyrë nëpërmjet kufirit Kapshticë gjithsej 15 534 emigrantë të parregullt, ndërsa për vitin 2021 kanë hyrë 13 228 migrantë.

Për shkak të fluksit në rritje të migrantëve të parregullt gjatë dy viteve të fundit, në vitin 2021, UNHCR kreu një investim të ri brenda territorit të Qendrës Tranzitore në Kapshticë, duke shtuar edhe dy kapanone (kontenier), me qëllim rritjen e kapaciteteve akomoduese të qendrës me 50 shtretër. Në këtë mënyrë, kapaciteti i qendrës nga 60 shtretër që ishte deri në vitin 2021, aktualisht është për pritjen dhe akomodimin e 110 personave. Stafii i punonjësve të policisë në këtë qendër, i cili përgjigjej për intervistimin, përzgjedhjen dhe trajtimin e migrantëve, nuk kishte mungesa në organikë.

*Në lidhje me verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të institucionit të Avokatit të Popullit nga viti i kaluar dhe referuar shkresës në përgjigje të këtyre rekomandimeve, nga Departamenti për Kufirin dhe Migracionin<sup>1</sup>, rezultoi se:*

---

<sup>1</sup> Rekomandimi i AP-së dt.22.11.2021. Shkresë nr.276 prot., datë 20.01.2022 e Departamentit për Kufirin dhe Migracionin drejtuar Avokatit të Popullit (MKPT).

1. Në zbatim të ligjit nr. 79/2021 “Për të Huajt”, është miratuar VKM nr.858, dt.29.12.2021 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e shtetasve të huaj në RSH”, ndryshuar me VKM 246, dt.20.04.2022. Po ashtu është miratuar VKM nr.857, dt.29.12.2021 “Për ngritjen dhe funksionimin e Regjistrit Elektronik Kombëtar për të huajt në Republikën e Shqipërisë”.<sup>2</sup> Ky regjistër administrohet nga Drejtoria e Përgjithëshme e Policisë së Shtetit dhe është funksional vetëm për ato struktura përgjegjëse që janë të ngarkuara me ligj.
2. Për vitin 2022, në matricën e trajnimeve është parashikuar trajnimi i strukturave të policisë kufitare dhe migracionit lidhur me njohjen e legjislacionit të ri për të huajt, si dhe me aktet e tjera nënligjore në zbatim të tij. Trajnimi fokusohet në zbatimin rigoroz të procedurave të intervistimit apo përzgjedhjes së shtetasve të huaj si në kufi ashtu dhe në territor, kryesisht të personelit që rekrutohet rishtas në policinë kufitare dhe migracionit.
3. Vështirësitë e hasura për përkthyes të disa gjuhëve të huaja, kishin gjetur zgjidhje me mbështetjen e përkthyesve të angazhuar nga FRONTEX dhe përkthimeve “on line” (vidiocall) të ofruara nga IOM apo UNHCR. Ndërkohë, Policia Kufitare dhe Migracionit po bën përpjekje për ngritjen e një sistemi të qëndrueshëm të përkthyesve duke përfutur dhe nga programe me vokacion rajonal (kryesisht nëpërmjet Regional Remote Interpretation Service (RRIS)).
4. Në dispozicion të shërbimeve të SPK Kapshticë, ishin dy automjete të llojit “furgon” me kapacitet 8+1 (donacione të IOM) për transportin e migrantëve të parregullt nga vendet e kapjes apo konstatimi në terren, deri në SPK Kapshticë. Këto automjete përdoren gjithashtu për transportin e tyre për në NJMF Bilisht dhe Bashkinë Korçë, apo dhe për dhënien e ndihmës mjekësore në spitalet e Bilishtit dhe të Korçës. Sipas informacionit, për rastet kur migrantët kapen në terrene malore, për transportin e tyre përdoren 3(tre) automjete tip Landrover 4x4, duke respektuar masat e parashikuara në protokollet për mbrojtjen nga COVID-19, në varësi të ecurisë së masave të parashikuara për këtë çështje.
5. Për kryerjen e shërbimeve të mirëmbajtjes, pastrimit dhe dizifektimeve periodike në Qendrën tranzitore të pritjes së migrantëve në Kapshticë, **nuk** është siguruar personel shtesë në varësi të policisë kufitare dhe migracionit Korçë. Gjithsesi rezulton se, kujdesi dhe mirëmbajtja e ambienteve të kësaj qendre është realizuar me mbështetje nga Caritas Albania.
6. Në lidhje me rekomandimin për krijimin e tendave mbrojtëse në mjediset e jashtme në Qendrën e Kapshticës, sipas informacionit, me ndihmën e donatorëve privatë (biznese në rrethin e Devollit), brenda vitit 2022 do të mundësohet ndërtimi i dy tendave të vogla me stola druri për qëndrimin e migrantëve gjatë stinës së verës.

---

<sup>2</sup> Ky regjistër disponohet dhe është i aksesueshëm nga DPPSH dhe jo nga pikat kufitare ku migrantët hyjnë.

7. Në bashkëpunim me Bashkinë Bilisht, është zgjidhur plotësisht problemi i pastrimit të mbetjeve në Qendrën provizore të pritjes së migrantëve në Kapshticë, duke kryer tërheqjen e tyre 3 herë në javë, sipas një grafiku të miratuar midis dy institucioneve.
8. Në lidhje me trajtimin e të miturve të pashoqëruar, Departamenti për Kufirin dhe Migracionin ka forcuar më shumë bashkëpunimin institucional me Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, sipas parashikimeve të VKM nr.111, datë 6.3.2019 “Për procedurat dhe rregullat për kthimin e riatdhesimin e fëmijës”.

*Ndërkohë, disa nga rekomandimet e MKPT-së nuk ishin realizuar, por sipas informacionit të drejtuesve të policisë, ato ishin në proces:*

1. Qendra për Akomodimin e të miturve të huaj të pashoqëruar e ngritur në Bashkinë Ersekë, **nuk** ka funksionuar që nga krijimi i saj. Kjo u konstatua nga grupi inspektimit të MKPT-së në këtë qendër, ku rezultoi se, me vendim të Bashkisë Ersekë kjo qendër është mbyllur që në vitin 2020. Në këto kushte, strukturat e policisë kufitare dhe migracionit, po bashkëpunojnë me qendrat sociale në Bashkinë Bilisht dhe në Korçë, për akomodimin e të miturve të huaj të pashoqëruar.
2. Ende nuk është arritur të nënshkruhet një protokoll dypalësh ripranimi me Greqinë, me gjithë kërkesat e vazhdueshme të palës shqiptare. Por, sipas informacionit, menaxhimi i situatës migrative, si dhe procesi i ripranimit me Greqinë, ka vijuar normalisht, bazuar në Marrëveshjen ndërmjet Shqipërisë dhe Komunitetit Europian, për ripranimin e personave me qëndrim të paautorizuar.
3. Në Qendrën Provizore të migrantëve të parregullt në Kapshticë, nuk kryhen testet e shpejta PCR, për parandalimin e infektimit COVID-19, me qëllim ruatjen e sigurisë së jetës dhe shëndetit të migrantëve të huaj të parregullt, por dhe personelit të policisë kufitare. Vlen të theksohet se situata e infektiveve është përmirësuar në tërë vendin.

### **Legjislacioni vendas dhe ai ndërkombëtar për Azilin**

E drejta për të kërkuar dhe përfituar azil për shtetasit e huaj, është e parashikuar në sistemin ndërkombëtar për të drejtat e njeriut. Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut e vitit 1948, në Nenin 14.1 thuhet shprehimisht se: “Çdokush ka të drejtë të kërkojë dhe gëzojë në vende të tjera azil nga përndjekja”.

Njohja e statusit të refugjatit nga shtetet, ka marrë formën e traktatit nëpërmjet “Konventës së Gjenevës” e Kombeve të Bashkuara, që njihet si Konventa për Statusin e Refugjatit, e datës 28 korrik 1951, e ndryshuar me protokollin e Nju Jorkut, të datës 31 janar 1967, e ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë. Këtë të drejtë e gëzojnë refugjatët të cilët përkufizohen në Nenin 1 të Konventës, ku thuhet shprehimisht se: *[një] person që, për shkak të frikës së bazuar të persekutimit, për arsye të racës, fesë, kombësisë, anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror apo bindjes politike, ndodhet jashtë vendit të shtetësisë së vet dhe nuk ka mundësi, ose për shkak të një frike të tillë, nuk ka dëshirë të kërkojë*

*mbrojtjen e atij vendi; ose kur ai, duke mos pasur shtetësi dhe ndodhet jashtë vendit të mëparshëm të banimit të zakonshëm të tij, si pasojë e këtyre ngjarjeve, nuk ka mundësi ose nuk ka dëshirë të kthehet atje, për arsye të kësaj frike.”*

Mbrojtja më e rëndësishme që merr një refugjat është, së pari, moskthimi në vendin e vet, ku është objekt i persekutimit. (kthimi – ndalohet nga Neni 33 i kësaj Konvente). Ka disa dispozita për përfundimin e statusit apo përjashtimin të cilat nënkuptojnë se, disa njerëz megjithëse janë në përputhje me përkufizimin e refugjatit, mund ta humbasin statusin e refugjatit apo mund të përjashtohen nga mbrojtja për shkaqe që parashikohen në Nenin 1 C-F të Konventës për Refugjatët.

Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Torturës e vitit 1984 e zgjeron më tej detyrimin për moskthim duke përfshirë çdo person i cili rrezikon t’i nënshtrohet torturës. Neni 3.1 i saj përcakton: “[asnjë] Shtet Palë nuk dëbon, kthen, (‘refouler’) apo ekstradon një person tek një shtet tjetër kur ka arsye thelbësore për të besuar se ai rrezikon t’i nënshtrohet torturës”. Ky ndalim është absolut dhe nuk pranon asnjë përjashtim. Siç vihet re edhe në përkufizimet për refugjatin dhe përfituesin e mbrojtjes nga tortura, njohja e refugjatit, si i tillë, mund të bëhet vetëm kur aplikanti është jashtë vendit të tij të origjinës. Për sa kohë që aplikanti është ende në vendin e tij të origjinës apo të banimit të zakonshëm, atëherë, sipas Konventës së Kombeve të Bashkuara për Refugjatët, ai nuk mund të njihet si refugjat.

Në të njëjtën mënyrë, një person i cili ka frikë se do t’i nënshtrohet torturës, nuk mund të marrë mbrojtje ndërkombëtare nëse është ende në vendin e tij të origjinës ose të vendbanimit të zakonshëm. Personi duhet të ketë kaluar një kufi ndërkombëtar dhe të ketë arritur në një vend tjetër me qëllim që të përfitojë azil dhe mbrojtje nga kthimi në vendin e tij.

E drejta për të kërkuar dhe përfituar azil gjendet e mishëruar edhe në Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut dhe Kartën e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore, megjithatë ajo ende nuk është bërë e drejtë që të merret në shqyrtim nga gjykatat. Pra, ekziston një hendek mes individit i cili përpiket të shpëtojë nga persekutimi apo tortura dhe detyrimit të shteteve nënshkruese të Konventës për Refugjatët dhe Konventës kundër Torturës për të mos i kthyer ata.

Një nga shqetësimet e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët është se shumë vende, në Evropë dhe gjetkë, po shfrytëzojnë këtë boshllëk me qëllim shmangien e detyrimeve të tyre për të dhënë mbrojtje. Për sa kohë që janë ndërmarrë masat për të parandaluar largimin e njerëzve nga vendi i tyre i origjinës ose mbërritjen e tyre në vendin e destinacionit dhe kërkimin e azilit, atëherë në sytë e këtyre shteteve refugjatët nuk “ekzistojnë” ose nuk janë përgjegjësi e shtetit që ka vendosur masat.

Sa më sipër, edhe Shqipëria duhet të sigurojë respektimin e detyrimeve të tyre për të drejtat e njeriut, ashtu siç parashikohen veçanërisht nga Konventa ndërkombëtare. E drejta e gjithkujt për t’u larguar nga çdo vend, përfshirë edhe vendin e vet, është një e drejtë

njerëzore e cila është e nënkuptuar edhe në të drejtën për jetë private dhe familjare, e parashikuar në Nenin 8. Për më tepër, e drejta e gjithkujt për t'u larguar nga vendi i vet duhet të sigurohet në mënyrë të barabartë si për shtetasit, ashtu edhe për të huajt dhe nuk duhet t'i nënshtrohet kurrë ndërhyrjeve që motivohen nga diskriminimi racial.

Lidhur me këtë çështje, Progres Raportit i Komisionit Evropian për vitin 2022 për Shqipërinë, në Kapitullin “Drejtësia, Liri dhe Siguria”, thuhet se: “Sa i përket migracionit, kuadri ligjor për migracionin është kryesisht në përputhje me *acquis-in* e BE-së, por me nevojat për përditësimin dhe duhet të sigurojë një kornizë të qartë për menaxhimin dhe koordinimin e migracionit. Numri i migrantëve të parregullt të kapur në Shqipëri në vitin 2021 është ulur me rreth 15% krahasuar me vitin 2020. **Nuk është bërë përparim në referimet për procedurën e azilit dhe zbatimin e procedurave të kthimit në përputhje me kuadrin ligjor. Politika e Shqipërisë për vizat duhet të përafrohet atë të BE-së**”<sup>3</sup>.

Në Progres Raport, theksohet gjithashtu se shteti shqiptar ka miratuar gjatë vitit 2021-2022 paketën ligjore ku përfshihet ligji nr.113/2020 “Për Shtetësin”, ligji nr.79/2021 “Për të huajt”<sup>4</sup>, si dhe ligji nr.10/2021 “Për Azilin në Republikën e Shqipërisë”<sup>5</sup>.

Nisur nga statistikat e periudhës 6-mujore të këtij viti, nga 2328 persona që kanë hyrë në territorin e Shqipërisë nga kufiri me Greqinë në zonën e Kapshticës, në intervistat e zhvilluara nga ekipet e policisë kufitare në bashkëpunim me FRONTEx, rezulton se, **asnjë nga migrantët e parregullt nuk kishte aplikuar me kërkesë autoritetit shtetëror në vendin tonë për Azil.**

---

<sup>3</sup> <https://www.dap.gov.al/publikime/dokumenta-strategjik/63-progres-raportet>

<sup>4</sup> Ky ligj është përafëruar pjesërisht me Direktivën 2004/38/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 29 prill 2004, “Mbi të drejtën e shtetasve të Bashkimit Evropian dhe të anëtarëve të familjeve të tyre për të lëvizur dhe qëndruar lirish brenda territorit të Shteteve Anëtare”, që ndryshon Rregulloren (KEE) dhe shfuqizon Direktivat 64/221/KEE, 68/360/KEE, 72/194/KEE, 73/148/KEE, 75/34/KEE, 75/35/KEE, 90/364/KEE, 90/365/KEE dhe 93/96/KEE, të ndryshuar. Numri CELEX 32004L0038, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, nr. 158, datë 30.4.2004, faqe 77-123.

<sup>5</sup> Ky ligj është përafëruar pjesërisht me:

- Direktivën e Këshillit 2001/55/KE, datë 20 korrik 2001 “Mbi standardet minimale për dhënien e mbrojtjes së përkohshme në rastet e flukseve masive të personave të shpërngulur dhe mbi masat që promovojnë një ekuilibër përpjekjesh ndërmjet Shteteve Anëtare në pritjen e këtyre personave dhe përbalimin e pasojave”. Numri CELEX 32001L0055, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 212, datë 7.8.2001, fq. 12-23.

- Direktivën e Këshillit 2003/86/KE, datë 22 shtator 2003 “Mbi të drejtën e bashkimit familjar”. Numri CELEX 32003L0086, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 251, datë 3.10.2003, fq. 12-18.

- Direktivën 2011/95/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 13 dhjetor 2011 “Mbi standardet për kualifikimin e shtetasve të vendeve të treta ose personave pa shtetësi si përfitues të mbrojtjes ndërkombëtare, për një status uniform për refugjatët ose për personat që kanë të drejtë për mbrojtje plotësuese, dhe për përmbajtjen e mbrojtjes së dhënë”. Numri CELEX 32011L0095, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L nr. 337, datë 20.12.2011, fq. 9-26.

- Direktivën 2013/32/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 26 qershor 2013 “Mbi procedurat e zakonshme për dhënien dhe tërheqjen e mbrojtjes ndërkombëtare”. Numri CELEX 32013L0032, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr.180, datë 29.6.2013, fq. 60-95.

- Direktivën 2013/33/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 26 qershor 2013 “Për përcaktimin e standardeve për pranimin e kërkuesve për mbrojtje ndërkombëtare”. Numri CELEX 32013L0033, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr.180, datë 29.6.2013, fq. 96-116.

Ndërkohë, strukturat e policisë për kufirin dhe migracionin në DRKM Korçë, kishin përpiluar **1349 urdhëra largimi** dhe brenda afatit 7 ditor ata ishin larguar vullnetarisht nga territori i vendit tonë. Për 10 persona (kryesisht fëmijë të pashoqëruar dhe gra), ishin krijuar kushte për ti sistemuar në qendrat sociale të Bashkisë Korçë.

Në vlerësimin e Institucionit të Avokatit të Popullit, strukturat shtetërore përgjegjëse për kufirin dhe migracionin, si dhe ato për Azilin, gjatë zbatimit të kontrolleve kufitare, intervistimit dhe përzgjedhjes së migrantëve, duhet të konsiderojnë dhe rishqyrtojnë kërkesat e migrantëve të parregullt për Azil, në harmonizim të plotë me ligjet, politikat dhe praktikat ndërkombëtare të parashikuara në Konventën dhe jurisprudencën e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, **duke ndaluar me efekt të menjëhershëm prapësimet**, të cilat i ndalojnë migrantët që të largohen nga vendi i tyre i origjinës apo që të arrijnë në BE, me qëllim që të ushtrojnë të drejtën e tyre për të kërkuar dhe gëzuar azil.

Referuar informacionit të marrë, rezulton se për vitin 2022 janë në proces për miratim një sërë aktesh nënligjore në zbatim të ligjit nr.79/2021 “Për të huajt” si, Projektvendimi “Për miratimin e formatit të aktit administrativ që vendos masën administrative dhe llojit të masave që përbëjnë shkak për kufizimin e hyrjes”; Projektvendimi “Për miratimin e formës dhe përmbajtjes së dokumentit të udhëtimit të të huajit, lejes së kalimit, letërnjoftimit, dublikatës, si dhe formatit të dokumentit të përkohshëm”; Projektvendim i Këshilli të Ministrave “Për Kuotat vjetore për punësimin e të huajve”; Projektvendim i Këshilli të Ministrave “Për profilin e zgjeruar të migracionit”; si dhe një sërë udhëzimesh dhe urdhërash të përbashkëta midis ministrive të fushave që janë përgjegjëse të ngarkuara me ligj.

### **Qendra e Pritjes së migrantëve Kapshticë**

Qeveria shqiptare, nëpërmjet autoriteteve dhe strukturave përgjegjëse që mbulojnë fushën e azilit dhe të refugjatëve me fokus respektimin e të drejtave të migrantëve në kuadër të mbrojtjes ndërkombëtare, në bashkëpunim me Organizatën Ndërkombëtare për Migracionin (IOM) në Shqipëri dhe Bankën për Zhvillim e Këshillit të Evropës (CEBD) që mbështesin aksesin e migrantëve në strehim, kujdes mjekësor, higjenë dhe shërbime të tjera thelbësore të nevojshme, **krijuan Qendrat për Regjistrimin dhe Akomodimin e Përkohshëm për migrantët e parregullt që hyjnë në Shqipëri nga kufiri me Greqinë, në SPK Kakavijë dhe SPK Kapshticë.**

Qendra për Regjistrimin dhe Akomodimin e Përkohshëm të migrantëve të parregullt në Kapshticë, është hapur dhe ka filluar të funksionojë në datë 29 Tetor të vitit 2019, në kuadër të projektit “Përmirësimi i kapaciteteve pritëse dhe aksesit në shërbime për migrantët dhe refugjatët që hyjnë në Shqipëri përmes Kapshticës, Korçë”.

Qendra është e ndërtuar me kontenier dhe ka në përbërje të saj njësitë e banimit për migrantët dhe familjet e tyre, një ambient më vehte intervistimi në shërbim të punonjësve të policisë kufitare shqiptare dhe një ambient intervistimi për ekspertët e FRONTEX, dhoma e mjekut dhe urgjencës, mjedisi për ngrënien e ushqimit, si dhe njësitë që shërbejnë

si tualete dhe dushe, për mbajtjen e higjenes personale dhe për larjen e trupit me ujë të ngrohtë.

Sikurse e theksuam më lartë, kapaciteti i qendrës ishte për mbajtjen e 110 personave. Gjatë vitit 2021, për shkak të fluksit në rritje të migrantëve të parregullt, UNHCR i zgjeroi kapacitetet e kësaj qendre me ndërtimin e kabanoneve të rinj edhe për 50 persona të tjerë, nga 60 persona që ishte kapaciteti që nga krijimi i saj. Njësitë e akomodimit kanë dhoma, me një kapacitet për 4 persona në dhomë<sup>6</sup>. Ato janë të pajisur me nga 2 krevatë në formë marinari për fjetje dhe të kompletuara me dyshekë, batanije dhe jastek, si dhe tavolinë për ngrënie e stola për qëndrimin ulur. Çdo dhomë është e pajisur me kondicioner për ngrohje dhe ftohje. Pajisjet e hotelerisë janë të kompletuara nga CARITAS.

Në rastet kur në dhoma akomodohen familje mbi katër persona, kushtet e fjetjes vështirësohen, ndaj në çdo rast, kjo bëhet me kërkesën e anëtarëve të familjes së migrantëve. Për të mënjeluar çdo dyshim në lidhje me këtë çështje, paraqitja e kërkesës duhet të bëhet me shkrim e të mbetet e dokumentuar.

Në momentin e inspektimit, në Qendër nuk ndodhej asnjë migrantë. Sipas informacionit të punonjësve të policisë në këtë qendër, në rastet kur ka flukse migratore koha e qëndrimit të tyre në qendër nuk shkon më shumë se 24 orë, deri në përfundim të përpunimit të të dhënave të tyre.

Në përfundim të procedurave të intervistimit dhe përzgjedhjes, migrantët që plotësojnë kërkesat për azil apo identifikohen si persona me precedent penal, dërgohen sipas rastit në Qendrën Kombëtare Pritëse për Azilkërkuesit në Babrru ose në Qendrën e Mbyllur për të Huajt në Kareç. Pjesa më e madhe e migrantëve të parregullt, kryesisht ata që ishin përsëritës, pajiseshin me urdhër largimi vullnetarë, pasi në të kundërt me automjetet e policisë kufitare ata shoqëroheshin për në kufirin me greqinë, nga ku kishin hyrë në kufi me Shqipërinë. Fëmijët e pashoqëruar dhe gratë e vetmuara, sistemoheshin në Qendrat sociale në Korçë dhe në Tiranë.

Mirëmbajtja dhe funksionimi i Qendrës në Kapshticë, sigurohet me fondet e UNHCR dhe IOM, ndërsa siguria realizohet nga policia kufitare e stacionit të policisë. Personeli ndihmës si përkthyesi, psikologu, mediatori kulturor, mjeku dhe sanitaret, punonin me kohë të pjesëshme (me orare në varësi flukseve të migrantëve) dhe siguroheshin nga CARITAS.

CARITAS kryente dhe furnizimin me ushqime catering dhe veshmbathjet e nevojshme për migrantët. Ngrohja dhe ftohja realizoheshin me kondicioner të vendosur në çdo njësi banimi dhe shërbimi. Furnizimi me ujë kryhej rregullisht nga ujësjellsi i Bashkisë Bilisht përgjatë 24 orëve.

---

<sup>6</sup> Kontenierët që shërbejnë për strehimin e migrantëve kanë dhoma me sipërfaqe 5x4m2.



Avokati i Popullit vlerëson bashkëpunimin e Policisë së Shtetit me organizmat ndërkombëtare për garantimin e të drejtave të migrantëve të parregullt, por Policia e Shtetit në kuptim e në bazë të ligjit duhet të ketë kapacitete të mjaftueshme njerëzore dhe financiare për të kryer këtë funksion në një mënyrë të pavarur.

Struktura organike e SPK Kapshticë, për kontrollin e kufirit të gjelbër dhe Qendrën Tranzitore të pritjes së migrantëve përbëhet nga 58 punonjës policie. Nga informacioni, kushte vetëm 1 mungesë në pozicionin e përgjegjës të turnit, pasi vendet vakante të konstatuara në inspektimet e mëparshme, ishin të plotësuara.

Stafi i punonjësve të policisë që shërbente në terren dhe ai që merrej në intervistimin e migrantëve të parregullt, ishin të trajnuar në seminare të organizuara nga OSBE, për mënyrën e trajtimit dhe mbi procedurën e intervistimit dhe të përzgjedhjes së tyre.

Për monitorimin e situatës migratore dhe trajtimin e migrantëve në bazë të të drejtave të tyre ligjore dhe mbrojtjes ndërkombëtare, pranë kësaj qendëre funksionon edhe **roli i ekspertit të Avokatit të Popullit**, i cili mbi bazën e një marrëveshje të institucionit me UNHCR, monitoron dhe vëzhgon punën e punonjësve të policisë në pikën e kalimit të kufirit dhe Qendrën e pritjes së migrantëve të parregullt në Kapshticë, në lidhje me respektimin e të drejtave të tyre, procedurat e shoqërimit të migrantëve për në qendër, kushtet infrastrukturore dhe të akomodimit, mënyrën e intervistimit dhe të përzgjedhjes, sipas kategorive dhe kryesisht grupet vulnerabël.

Nga informacioni i ekspertit të institucionit të Avokatit të Popullit, rezulton se, intervistimi i migrantëve **nuk** bëhet i thelluar nga punonjësit e policisë kufitare në lidhje me procedurat kryesisht me kërkesat për azil në Shqipëri.

Kërkesat për azil plotësohen vetëm në rastet kur migrantët e kërkojnë me vullnetin dhe insistimin e tyre. Më tej, këta persona shoqërohen për në Qendrën e pritjes të migrantëve në Babrru, Tiranë, deri në pritjen të miratimit ose jo të kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare, nga Autoriteti Përgjegjës për Azilin dhe Refugjatët në Ministrinë e Brendshme.

Gjithashtu, për migrantët që ju plotësohet urdhëri i largimit, **nuk** zbatohet afati i qëndrimit në territor deri në 7(shtatë) ditë në mënyrë vullnetare, por punonjësit e policisë kufitare i largojnë ata me automjetet e tyre deri në pikën e kalimit të kufirit me Greqinë në mënyrë të menjëherëshme.

Migrantët që rezultojnë përsëritës, që kanë hyrë në territorin e vendit tonë më shumë se një herë, pyeten për gjeneralitet, ju merren shenjat e gishtave dhe i kthejnë menjëherë në kufirin e gjelbërt, pa marrë në konsideratë rastet në nevojë apo personat me familje.

Nga inspektimi u evidentua se, mungesa e përkthyesit për gjuhë të veçanta si Dari, Fars etj., ishte zgjidhur nga FRONTEx nëpërmjet përkthimeve me video-call. Sipas rasteve, intervistimi kryhet edhe në gjuhën angleze.

Dhoma e mjekut shërbente për kryerjen e vizitave mjekësore rutinë me migrantët, ndërsa për nevoja të vizitave mjekësore më të specializuara, ata dërgoheshin në spitalin e Bilishtit.

Ankesat/kërkesat e migrantëve shënoheshin në një libër të veçantë nga shefi i stacionit të policisë kufitare, Kapshticë, i cili ngarkonte dhe personin përgjegjës për zgjidhjen e tyre. Kryesisht, kërkesat e tyre kishin të bënin me takim me mjekun për vizitë mjekësore, si dhe për përkthyes në gjuhën e tyre.

Në zyrën e intervistimit, si dhe në çdo njësi banimi ishin të afishuar postera me të drejtat e migrantëve në disa gjuhë të huaja si Anglisht dhe në gjuhën Arabe.

Përpunimi i mbetjeve përgjithësisht realizohej nga Bashkia e Devollit, por në rastet kur ka mbipopullime, është e nevojshme një menaxhim më efektiv nga ana e tyre, pasi nga grumbullimet për kohë të gjatë të mbetjeve, mundësia për të krijuar vatra infeksioni dhe sëmundje të migrantëve që mbërrijnë pas udhëtime të gjata në qendër, është më e lartë.

Nga inspektimi i kryer në Stacionin e policisë së kufirit në Kapshticë, si dhe nga monitorimi i vazhdueshëm që institucioni i Avokatit të Popullit kryen në terren nëpërmjet ekspertit në pikën kufitare të Kapshticës që prej vitit 2019, konstatojmë se dhe në këtë Qendër, **stafet mbështetëse dhe investimet në Qendrat e pritjes së migrantëve të parregullt, janë kryer nga donatorë dhe partnerë të ndryshëm ndërkombëtarë dhe asnjë prej tyre nuk është kryer me fondet e buxhetit të shtetit shqiptar.**

### **Ambientet e intervistimit, ndihma juridike dhe psikologjike**

Migrantët e parregullt, pasi konstatohen nga rojet kufitare dhe shoqërohen për në qendrat e pritjes, i nënshtrohen një procedure trajtimi të përafuar me ato të vendeve të BE-së. Procedura është e bazuar në Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr.293, datë 04.06.2015 *“Mbi trajtimin e të huajve me qëndrim të parregullt në RSHP”* dhe në procedurën standarde *“Për përzgjedhjen e të huajve të parregullt”*, miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë nr.172, datë 08.02.2018.

Punonjësit e policisë kufitare, kryejnë procedurën e verifikimit (screening proces) të flukseve migratore në mjedisin e intervistimit që ndodhet në Qendrën e pritjes së Migrantëve në Kapshticë. Ky ambient i plotëson kushtet për kryerjen nga punonjësi i policisë së kufirit të procedurave për identifikimin, intervistimin dhe përzgjedhjen e migrantëve.

Theksojmë se, gjatë gjithë procesit të intervistimit të migrantëve, ishin të pranishëm dhe asistonin me ndihmesën e tyre punonjësit e policisë kufitare edhe ekspertët e FRONTEx-

it, të cilët janë të vendosur aty mbi bazën e një marrëveshje që kanë me Qeverinë e Shqipërisë për kontrollin dhe menaxhimin e kufirit.

Nisur nga procedura që zhvillohet për verifikimin e migrantëve, ata kategorizohen me statusin si më poshtë:

**Azilkërkues** - Kjo kategori dërgohet në Qendrën Kombëtare të Azilkërkuesve në Babrru. Gjatë vitit 2022, sikurse e referuam edhe më lart numri i personave të referuar për azil nga kjo Qendër ishte i papërfillshëm.

**Viktimë trafikimi apo viktimë e mundshme trafikimi** - Kjo kategori i referohet menjëherë strukturave antitrafik të Policisë së Qarkut Korçë. Gjatë vitit 2021 nuk ishte evidentuar në territorin e Korçës ndonjë rast i tillë.

**Imigrant i parregullt** –në rastet kur nga procedura e përzgjedhjes dhe intervistimit të migrantëve, konstatohet se qëllimi i tyre është kalimi i tyre për në një nga vendet e BE-së, ndaj tyre merret urdhër largimi apo dëbimi nga territori i RSH, ndërsa në raste të shkeljeve ligjore ata ndalohen në Qendrën e Mbyllur për të Huajit në Karreç, Durrës.

**Fëmijë të pashoqëruar** - Kjo kategori identifikohet dhe intervistohet në prani të punonjësit të Njesisë së Mbrojtjes së Fëmijës së Bashkisë Devoll dhe Korçë, që përfshin territorin ku është identifikuar fëmija i pashoqëruar. Të gjitha rastet janë trajtuar dhe ndjekur në bashkëpunim me Njësinë e Mbrojtjes së Fëmijëve kryesisht pranë Bashkisë Korçë, ndërkohë që familjet, gratë apo fëmijët e tyre kanë qëndruar në Qendrën Sociale të bashkive respektive, deri në kryerjen e procedurave. Trajtimi i rasteve është bërë sipas VKM nr.111, datë 06.03.2019 “*Për procedurat e riatdhesimit të fëmijës*”.

Institucioni i Avokatit të Popullit nëpërmjet ekspertit të tij në zonën e Kapshticës, ka një rol proaktiv dhe në të ardhmen do të ketë një vëmendje më të shtuar, në lidhje me zbatimin korrekt të procedurave nga punonjësit e policisë të migracionit gjatë intervistimit, hetimit të thelluar dhe verifikimit të kësaj kategorie migrantësh (fëmijë) që hyjnë në territorin shqiptar.

Sjellim në vëmendjen tuaj një Raport të veçantë që UNICEF ka hartuar dhe ka trajtuar specifikisht për këtë kategori, raport i cili është diskutuar edhe në Kuvendin e Shqipërisë.<sup>7</sup> Raporti i referohet “Strategjisë kombëtare për migracionin 2019–2022” të Qeverisë Shqiptare, duke venë theksin te rekomandimet e adresuara për forcimin e kapaciteteve mbrojtëse për fëmijët, masave për adresimin e fëmijëve dhe të respektit ndaj fëmijëve migrantë të pambrojtur, si dhe për t'i ndihmuar ata me infrastrukturë të përmirësuar kufitare (përfshirë ata më të cënueshëm, të pashoqëruar dhe të ndarë fëmijët dhe fëmijët aktualë/potencialë viktimë të trafikimit). Ai parashikon gjithashtu masa ri-integrimi për të gjithë fëmijët e kthyer për tu siguruar bashkimin e tyre familjar dhe shtetësinë, duke adresuar nevojat e tyre për strehim, arsim dhe kujdes shëndetësor. Në raport vihet theksi se, në nivel lokal nuk ka plane specifikisht për migrantët e kthyer<sup>8</sup>.

<sup>7</sup> <https://www.unicef.org/albania/reports/albania-child-notice-2021>

<sup>8</sup> Fq105, paragraph 350, <https://www.unicef.org/albania/reports/albania-child-notice-2021>

Të drejtat e migrantëve kanë qenë prej kohësh një shqetësim kryesor për Institucionet Kombëtare Evropiane të të Drejtave të Njeriut (NHRI). Si organe të pavarura të mandatuara nga shteti, NHRI-të luajnë një rol kyç në monitorimin, promovimin dhe mbrojtjen e këtyre të drejtave, veçanërisht në kufi. Në të njëjtën kohë, ato ndihmojnë në sigurimin e llogaridhënies kur ndodhin shkelje. Mandatet e gjera të NHRI-ve nënkuptojnë se ato përbëjnë një pjesë thelbësore të çdo sistemi efektiv të llogaridhënies për të drejtat e njeriut. Për këtë qëllim, Rrjeti Evropian i NHRI-ve (ENNHRI) ka hartuar rekomandime bazuar në informacionin dhe tendencat e identifikuar në punën e NHRI-ve, për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut të migrantëve në kufi. Ato përshkruajnë hapat që mund të ndërmarrin aktorët përkatës në nivel kombëtar dhe rajonal për të siguruar qeverisje të ndjeshme ndaj të drejtave të njeriut në kufi. Ndër këto rekomandime, vlen për t'u përmendur identifikimi dhe ofrimi i kujdesit për migrantët kryesisht ndaj grupeve vulnerabël. NHRI-të evropiane, kanë venë theksin se autoritetet kombëtare dhe evropiane, duhet të ofrojnë mbrojtjen e grupeve vulnerabël në kufi, duke përfshirë edhe identifikimin efektiv të procedurave dhe mekanizmave të referimit.

Shtetet duhet të rrisin kapacitetin e tyre për të identifikuar dhe mbështesin njerëzit në rrezik në kufi, duke bërë të pamundurën për të zbatuar këshillat e Planit të Veprimit të Evropës për Mbrojtjen e Personave të Cënueshëm në Kontekstin e Migracionit dhe Azili në Evropë (2021-2025). Përdorimi i gjerë i ndalimit të imigracionit, duke përfshirë edhe familjet dhe kategorinë e të të pashoqëruarve fëmijë, që është një nga shqetësimet kryesore të IKDNJ-ve në lidhje me politikat aktuale rajonale dhe kombëtare në kufijtë e jashtëm të BE-së.<sup>9</sup>

Të drejtat e migrantëve janë në një vëmendje të shtuar edhe të Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët, i njohur gjithashtu si Agjencia e Kombeve të Bashkuara për Refugjatët. Në raportin e muajit Shkurt 2022 UNHCR evidenton se në katër vitet e fundit, Shqipëria ishte dëshmitare e një rritje të dukshme në numrin e refugjatve dhe emigrantve që vijnë në lëvizje të përziara, duke mbingarkuar kërkesat për azilin dhe menaxhimin e kufirit. Në vitin 2021, Shqipëria miratoi ligje të reja për azil dhe për të huajt, më tej për afrooi me ndërkombëtarët dhe BE-në standardet dhe vendosjen e bazës për procedurën e përcaktimit të pashtetësisë. MPB, UNHCR dhe IOM janë duke avancuar drejt rrugëve të diferencuara dhe procedurat për të adresuar lëvizjet migratore duke rritur ngritjen e kapaciteteve dhe përmirësimin e procedurave<sup>10</sup>.

Në përfundim, Avokati i Popullit në kuadër të misionit të tij kushtetues dhe ligjor, do të vijojë në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të shtetsave të huaj dhe kryesisht të migrantëve të parregullt që hyjnë në territorin e vendit tonë, duke siguruar standarde më të larta në respektimin e këtyre të drejtave, sikurse janë parashikuar në aktet ligjore dhe aktet ndërkombëtare.

---

<sup>9</sup> <https://ennhri.org/wp-content/uploads/2021/10/ENNHRI-Recommendations-Infographic.pdf>  
<https://www.unhcr.org/623469b239.pdf><sup>10</sup>

Për sa më sipër dhe në mbështetje të pikës 3, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”; germa “b”, të nenit 21 të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive;

### **REKOMANDOJMË:**

1. Të merren masat e nevojshme nga autoriteti shtetëror përgjegjës të ngakuara në ligj si Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës dhe Departamenti për Kufirin dhe Migracionin në DPSH, për bashkërendimin e punës midis tyre, si dhe për të garantuar funksionimin e sistemit të integruar të mbrojtjes për fëmijët e pashoqëruar brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në Vendimin nr.111, datë 6.3.2019 “Për procedurat dhe rregullat për kthimin e riatdhesimin e fëmijës”.
2. Të merren masa të menjëhershme, në bashkëpunim me institucionet e tjera shtetërore të ngarkuara me ligj, për ngritjen e vënien në funksionim të një Qendre të re për sistemimin dhe akomodimin e fëmijëve të pashoqëruar, duke përcaktuar buxhete për investime në këtë qendër, si dhe për plotësimin e stafit me psikologë dhe punonjës social për trajtimin e tyre, si dhe staf policie për ruajtjen e tyre.
3. Të merren masat e nevojshme për miratimin e plotë të akteve nënligjore në zbatim të kërkesave të përcaktuara në ligjin nr.79/2021 “Për të huajt”, konkretisht projektvendimet: “Për miratimin e formatit të aktit administrativ që vendos masën administrative dhe llojit të masave që përbëjnë shkak për kufizimin e hyrjes”; “Për miratimin e formës dhe përmbajtjes së dokumentit të udhëtimit të të huajit, lejes së kalimit, letërnjoftimit, dublikatës, si dhe formatit të dokumentit të përkohshëm”; “Për Kuotat vjetore për punësimin e të huajve”; si dhe “Për profilin e zgjeruar të migracionit”.
4. Të merren masat e nevojshme për organizmin e trajnimeve të stafit të policisë kufitare, me qëllim ngritjen e kapaciteteve të stafit që kryerjnë procedurat e intervistimit dhe për zgjedhjes të migrantëve të parregullt, në rritjen e numrit të kërksave të migrantëve për Azil në Shqipëri, si dhe në garantimin e mbrojtjes ndërkombëtare për këta persona, sikurse parashikohet në aktet ligjore dhe aktet ndërkombëtare, për këtë qëllim.
5. Vijimin e përpjekjes për marrjen e masave të nevojshme për nënshkrimin e një marrëveshje bashkëpunimi me palën e policisë kufitare greke, në lidhje me përcaktimin e një protokollit të rregullt ligjor, për ripranimin e shtetasve të huaj që kanë hyrë në mënyrë të parregullt nga territori grek në territorin e Shqipërisë, si në rastet kur ata janë përsëritësa, por dhe rastet kur atyre nuk ju miratohet statusi i azilkërkuesit nga autoritetet shqiptare të përcaktuara në ligj.

6. Në momentin e flukseve migratore, të situatës së pandemisë të merren masa në bashkëpunim me autoritetet shëndetësore në Bilisht, për kryerjen e testeve të shpejta PCR të migrantëve të parregullt, duke marrë parasysh situatën e masave anti-COVID-19, me qëllim ruajtjen e sigurisë së jetës dhe shëndetit të migrantëve të parregullt, por dhe personelit të policisë kufitare.
7. Të merren masat e nevojshme, për krijimin e tendave mbrojtëse në mjediset e jashtme në Qendrën e pritjes së migrantëve Kapshticës, për të lehtësuar qëndrimin e emigrantëve edhe në ambientet e jashtme të qendrës, kryesisht për stinën e verës.
8. Të merren masa që në vijim hapja dhe shqyrtimi i ankesë/kërkesave të migrantëve, të kryhet në prezencë edhe të përfaqësuesit të Avokatit të Popullit, që monitoron këtë pikë kufitare.
9. Të mbahet një vemëndje e shtuar, për identifikimin dhe ofrimin e kujdesit për migrantët kryesisht ndaj grupeve vulnerabël, sipas rekomandimeve të NHRI-ve evropiane, ku theksohet se autoritetet kombëtare dhe evropiane duhet të ofrojnë mbrojtjen e grupeve vulnerabël në kufi, duke përfshirë edhe identifikimin efektiv, procedurat dhe mekanizmat e referimit.

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.*

**KOMISIONER**

**Ahmet PRENÇI**